**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

# STANDARDI I PROFESIONIT

# "TEKNIK AUTOMJETI PËR SHËRBIMET MEKATRONIKE"

**Kodi 7231.20 (në LKP[1]):**

**Tiranë 2025**

[1] Lista Kombëtare e Profesioneve

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

# TEKNIK AUTOMJETI PËR SHËRBIMET MEKATRONIKE

**Kodi: 7231.20**

***Ekipi i verifikimit dhe vleftësimit:***

***Vlefshmëria e standardit: 4 vjet***

***Kërkesat për hyrje:***

***Disa kërkesa për hyrje në këtë profesion:***

- Zakonisht kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional të niveli të V të KSHK-së për këtë profesion.
- Të jetë në kushte shëndetësore që lejojnë kryerjen e detyrës.

***Data e miratimit:***

***Variantet e mëparshme:*** **3115.25 (LKP 2017)**

***Përshkrim i përgjithshëm i profesionit***

Tekniku/ja i/e mekatronikës së kamionëve diagnostikon, mban, shërben dhe riparon sistemet mekanike, elektrike, elektronike, hidraulike, pneumatike, pajisjet dhe skajet e tjera të automjetit.

Teknik/e i/mekatronikës së kamionëve planifikon aktivitete, përgatit burimet e nevojshme dhe hapësirën për kryerjen e punëve, realizon pranimin e automjetit, vendos diagnozën duke përdorur metoda dhe pajisje moderne, duke përdorur dokumentacionin teknik, sistemet e informacionit dhe komunikimit. Ai/Ajo kryen kontrollin, rregullimin, riparimin, zëvendësimin dhe mbikëqyrje të punimeve të sistemeve mekanike, hidraulike, pneumatike, elektrike dhe elektronike/pajisjeve/pjesëve dhe pajisjeve shtesë në automjet ose, sipas nevojës, i dërgon ato specialistëve.

Teknik/e i/mekatronikës së kamionëve mban dokumentacionin e punës dhe kryen punë administrative dhe komerciale nga fusha e punës së tij/saj. Ai/Ajo komunikon me eprorët, bashkëpunëtorët dhe përdoruesit e shërbimeve (diskuton dhe propozon mundësitë për zgjidhje sipas kërkesave) duke përdorur rregullat e komunikimit etik dhe profesional. Ai/Ajo përdor dhe siguron standardet e cilësisë, zbaton procedurat dhe masat për mbrojtjen e shëndetit, sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe zbaton masat për mbrojtje nga zjarri. Teknik/e i/mekatronikës së kamionëve gjatë kryerjes së detyrave të punës përdor teknologjitë moderne, pajisje/instrumente për matjen e të gjitha madhësive që është e nevojshme të përcaktohen, si dhe mjetet dhe pajisjet e duhura sipas udhëzimeve të prodhuesit.

<table>
<tr><th colspan="5">TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE</th></tr>
<tr><th>Funksionet</th><th>Përgjegjësitë /Detyrat</th><th>Njohuritë</th><th>Qëndrimet</th><th>Kriteret e performancës</th></tr>
<tr>
<td rowspan="8"><u>Funksioni 1</u><br><br>Kryen analizimin, planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të punës dhe parapërgatitjes për punë</td>
<td><u>Detyra 1</u><br>Analizon urdhrin e punës dhe dokumentacionin teknik</td>
<td rowspan="8">• Llojet e strukturave organizative të autoserviseve;<br>• Llojet e shërbimeve në një autoservis;<br>• Instrumente, pajisje dhe mjete të punës, funksioni dhe përdorimi i tyre;<br>• Të dhënat teknike të mjetit (Libreza e automjetit)<br>• Manualet teknike dhe rëndësia e përdorimit të tyre;<br>• Rëndësia e konsultimit me librin e shërbimeve të automjetit;<br>• Leximi i skemave dhe bllok-skemave të ndryshme;<br>• Llojet e programeve për diagnozën dhe për pjesët e këmbimit dhe përdorimi i tyre;<br>• Gjuhë e huaj teknike;<br>• Llojet e materialeve, përdorimi i tyre;<br>• Llojet e pajisjeve të punës, funksioni, karakteristika dhe përdorimi i tyre;<br>• Mënyrat e kontrollit të funksionalitetit dhe sigurisë të tyre në përputhje me standardet ;<br>• Planifikimi i punës sipas proceseve;<br>• Mënyrat e planifikimit të burimeve</td>
<td rowspan="8">• I/e përgjegjshëm/me<br>• Korrekt/e<br>• I/e përpiktë<br>• Bashkëpunues/e<br>• I/e saktë<br>• I/e kujdesshëm/me<br>• I/e vëmendshëm/me<br>• I/e komunikueshëm/me<br>• I/e dëgjueshëm/me<br>• I/e shkathët<br>• I/e duruar<br>• Këmbëngulës/e<br>• Largpamës/e</td>
<td rowspan="8">• Të analizojë urdhrin e punës dhe dokumentacionin teknik sipas rregullores së brendshme<br>• Të planifikojë orarin kohor të realizimit të punimeve në faza sipas ngarkesës dhe procedurave të brendshme;<br>• Të planifikojë burimet e nevojshme për realizimin e detyrave të punës sipas ngarkesës;<br>• Të organizojë grupet e punëtorëve/ekzekutuesve përgjegjës për realizimin e punimeve sipas grafikut të punimeve;<br>• Të koordinojë aktivitetet e veta me aktivitetet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të biznesit sipas kërkesës;<br>• Të kontrollojë kushtet e punës në vendin e punës sipas standardeve;<br>• Të përgatitë vendin e punës në përputhje me planin ditor të punës dhe prioritetet e punës;<br>• Të kontrollojë funksionalitetin e</td>
</tr>
<tr><td><u>Detyra 2</u><br>Planifikon orarin kohor të realizimit të punimeve në faza</td></tr>
<tr><td><u>Detyra 3</u><br>Planifikon burimet e nevojshme për realizimin e detyrave të punës</td></tr>
<tr><td><u>Detyra 4</u><br>Organizon grupet e punëtorëve/ekzekutuesve përgjegjës për realizimin e punimeve.</td></tr>
<tr><td><u>Detyra 5</u><br>Koordinon aktivitetet e veta me aktivitetet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve të biznesit</td></tr>
<tr><td><u>Detyra 6</u><br>Kontrollon kushtet e punës në vendin e punës</td></tr>
<tr><td><u>Detyra 7</u><br>Përgatit vendin e punës në përputhje me planin ditor të punës dhe prioritetet e punës</td></tr>
<tr><td><u>Detyra 8</u></td></tr>
</table>

| TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Funksionet** | **Përgjegjësitë /Detyrat** | **Njohuritë** | **Qëndrimet** | **Kriteret e performancës** |
| | Kontrollon funksionalitetin e mjeteve, mjeteve speciale, pajisjeve dhe makinerive (vinçat), pajisjeve matëse të nevojshme për realizimin e detyrës së punës<br>**<u>Detyra 9</u>**<br>Mbikëqyr përgatitjen e mjeteve, mjeteve speciale, pajisjeve dhe makinerive (vinçat), pajisjeve matëse të nevojshme për realizimin e detyrës së punës<br>**<u>Detyra 10</u>**<br>Kontrollon mirëmbajtjen dhe higjienën e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve<br>**<u>Detyra 11</u>**<br>Raporton për ecurinë e punës<br>**<u>Detyra 12</u>**<br>Organizon punën në një mënyrë egonomike | njerëzore;<br>• Mënyrat e planifikimit të burimeve materiale etj.;<br>• Rëndësia e koordinimit të punës për sigurimin e burimeve;<br>• Mënyra e hartimit të grafikut të punimeve sipas proceseve të punës;<br>• Ndarja e detyrave sipas agjendës ditore, javore dhe kualifikimeve përkatëse;<br>• Legjislacioni përkatës për kushtet e punës dhe vendit të punës;<br>• Mënyrat e mbledhjes së informacioneve për mbarëvajtjen e punëve;<br>• Format e bashkëpunimit me palë të treta dhe specialistë të tjerë;<br>• Format e raportimit;<br>• Rëndësia e mbikëqyrjes së organizimit ergonomik të vendit të punës;<br>• Procedura e monitorimit për zbatimin të rregullave për mirëmbajtjen dhe higjienën personale të mjeteve, pajisjeve dhe të vendit të punës; | • Fleksibël<br>• Praktik (SMART) | mjeteve, mjeteve speciale, pajisjeve dhe makinerive (vinçat), pajisjeve matëse të nevojshme për realizimin e detyrës së punës sipas manualeve përkatëse;<br>• Të mbikëqyrë përgatitjen e mjeteve, mjeteve speciale, pajisjeve dhe makinerive (vinçat), pajisjeve matëse të nevojshme për realizimin e detyrës së punës sipas grafikut të punimeve dhe manualeve përkatëse;<br>• Të kontrollojë mirëmbajtjen dhe higjienën e vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve sipas rregullores së brendshme dhe udhëzime të prodhuesve;<br>• Të raportojë për ecurinë e punës sipas rregullores së brendshme;<br>• Të organizojë punën në një mënyrë egonomike;<br>• Të plotësojë dokumentacionin dhe raportet sipas rregullores së brendshme; |
| | **<u>Detyra 1</u>**<br>Merr informacion nga urdhri i | • Procedurat dhe formatet e pranimit të | • I/e | • Të marrë informacion të detajuar |

| TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Funksionet** | **Përgjegjësitë /Detyrat** | **Njohuritë** | **Qëndrimet** | **Kriteret e performancës** |
| **Funksioni 2**<br><br>Kryen pranimin, diagnostikimin dhe inspektimin e defekteve në kamionë dhe mjete të rënda | punës<br>**Detyra 2**<br>Merr informacion nga drejtuesin e mjetit për problemet e raportuara dhe simptomat e defekteve<br>**Detyra 3**<br>Kryen inspektimin e jashtëm të automjetit<br>**Detyra 4**<br>Kryen diagnozën paraprake të automjetit<br>**Detyra 5**<br>Kontrollon funksionimin e motorit dhe funksioneve themelore gjatë punës në boshllëk<br>**Detyra 6**<br>Kryen kontroll vizual dhe akustik të mjetit me qëllim përcaktimin e mosfunksionimeve të elementeve, sistemeve dhe përbërësve të tij, bazuar në informacionet e marra nga klientët ose nga një provë e vozitjes.<br>**Detyra 7**<br>Kryen dokumentimin kontrolleve paraprake dhe planifikimin e | mjetit;<br>• Rëndësia e dokumentimit të gjendjes fillestare dhe historikut të diagnozës së mjeteve të rënda;<br>• Formati dhe elementët e një urdhri pune;<br>• Llojet e mjeteve të rënda, specifikimet dhe karakteristikat e tyre;<br>• Rëndësia dhe procedurat e inspektimit fizik të mjetin gjatë pranimit;<br>• Llojet e pajisjeve testuese dhe përdorimi i tyre;<br>• Llojet e pajisjeve dhe programeve diagnostikuese, si dhe përdorimi i tyre;<br>• Llojet e matjeve, instrumenteve matëse dhe përdorimet e tyre;<br>• Llojet e sistemeve ( elektrike, elektronike, mekanike ...) të mjeteve të renda dhe funksionimi i tyre;<br>• Procedurat e testimit të sistemeve;<br>• Procedurat e testimit të motorit;<br>• Procedurat e testimit të sistemit të transmetimit të fuqisë;<br>• Procedurat e testimit të sistemit të drejtimit dhe frenimit; | përgjegjshëm/me<br>• Korrekt/e<br>• I/e përpiktë<br>• Bashkëpunues/e<br>• I/e saktë<br>• I/e kujdesshëm/me<br>• I/e vëmendshëm/me<br>• I/e komunikueshëm/me<br>• I/e dëgjueshëm/me<br>• I/e shkathët<br>• I/e duruar<br>• Këmbëngulës/e<br>• Fleksibël<br>• Praktik | nga urdhri i punës;<br>• Të marrë informacion të detajuar nga drejtuesi i mjetit për problemet e raportuara dhe simptomat e defekteve<br>• Të kryejë inspektimin e jashtëm të automjetit sipas procedurave;<br>• Të kryejë diagnozën paraprake të automjetit sipas procedurave;<br>• Të kontrollojë funksionimin e motorit dhe funksioneve themelore gjatë punës në boshllëk, sipas manualeve përkatëse teknike;<br>• Të kryejë kontroll vizual dhe akustik të mjetit me qëllim përcaktimin e mosfunksionimeve të elementeve, sistemeve dhe përbërësve të tij, bazuar në informacionet e marra nga klientët ose nga një provë e vozitjes, sipas procedurës përkatëse .<br>• Të kryejë dokumentimin e kontrolleve paraprake dhe planifikimin e aktiviteteve të mëtejshme të mirëmbajtjes, sipas |

| TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Funksionet** | **Përgjegjësitë /Detyrat** | **Njohuritë** | **Qëndrimet** | **Kriteret e performancës** |
| | aktiviteteve të mëtejshme të mirëmbajtjes<br>**<u>Detyra 8</u>**<br>Kryen operacione diagnostikuese, mat dhe kontrollon parametrat mekanikë të mjetit duke përdorur pajisjet dhe softuerin e përshtatshëm për diagnostikim, si dhe mjetet dhe pajisjet matëse e kontrolluese, në modalitetin stacionar ose gjatë lëvizjes së mjetit.<br>**<u>Detyra 9</u>**<br>Teston sistemet elektrike dhe kontrollon funksionalitetin e rrjetit të sensorëve dhe aktuatorëve<br>**<u>Detyra 10</u>**<br>Analizon rezultatet e diagnostikimit përmes platformave kompjuterike të prodhuesit<br>**<u>Detyra 11</u>**<br>Përcakton vendin, shkallën dhe llojin e dëmtimeve dhe defekteve të elementeve dhe përbërësve të sistemeve të mjeteve, në përputhje me dokumentacionin teknik dhe | • Procedurat e testimit të sistemeve ndihmëse dhe të komfortit;<br>• Procedurat e testimit të sistemit të shkarkimit të gazrave;<br>• Llojet e defekteve kryesore sipas sistemeve<br>• Rëndësia e marrjes së informacionit mbi historikun e mjetit;<br>• Lidhja me porta komunikuese e të gjitha sistemeve të mjeteve të rënda me pajisjen diagnostikuese;<br>• Leximi i kodeve të gabimeve dhe analizimi i tyre;<br>• Rëndësia e përditësimeve të softuerit të paketave elektronike (ECU)sipas sistemeve;<br>• Procedurat e analizës së rezultateve të diagnostikimit përmes softuerëve përkatës;<br>• Simbolet përkatëse për leximin dhe interpretimin i skemave elektrike dhe elektronike;<br>• Opsionet e mundshme të riparimit dhe zëvendësimit të elementeve me defekt;<br>• Procedura e informimit të klientit dhe | (SMART)<br>• I/E kujdesshëm/me për detaje; | rregullores së brendshme;<br>• Të kryejë operacione diagnostikuese, mat dhe kontrollon parametrat mekanikë të mjetit duke përdorur pajisjet dhe softuerin e përshtatshëm për diagnostikim, si dhe mjetet dhe pajisjet matëse e kontrolluese, në modalitetin stacionar ose gjatë lëvizjes së mjetit, sipas procedurës përkatëse;<br>• Të testojë sistemet elektrike dhe kontrollon , funksionalitetin e rrjetit të sensorëve dhe aktuatorëve , sipas procedurës përkatëse;<br>• Të analizojë rezultatet e diagnostikimit përmes platformave kompjuterike të prodhuesit sipas manualeve të prodhuesit;<br>• Të përcaktojë vendin, shkallën dhe llojin e dëmtimeve dhe defekteve të elementeve dhe përbërësve të sistemeve të mjeteve, në përputhje me dokumentacionin teknik dhe udhëzimet e prodhuesit, bazuar në diagnostikimin e kryer; |

| TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Funksionet** | **Përgjegjësitë /Detyrat** | **Njohuritë** | **Qëndrimet** | **Kriteret e performancës** |
| | udhëzimet e prodhuesit, bazuar në diagnostikimin e kryer.<br>**<u>Detyra 12</u>**<br>Ruan historikun e diagnozës së mjetit<br>**<u>Detyra 13</u>**<br>Analizon opsionet për riparimin ose zëvendësimin e elementeve dhe përbërësve të dëmtuar të sistemeve të mjeteve ose për analizë të mëtejshme (bazuar në rezultatet e diagnostikimit, kriteret e përcaktuara ose udhëzimet e eprorit).<br>**<u>Detyra 12</u>**<br>Informon klientin/eprorin për gjetjet dhe procedurat e mëtejshme | eprorit sipas rregullores se brendshme . | | • Të analizojë opsionet për riparimin ose zëvendësimin e elementeve dhe përbërësve të dëmtuar të sistemeve të mjeteve ose për analizë të mëtejshme (bazuar në rezultatet e diagnostikimit, kriteret e përcaktuara ose udhëzimet e eprorit), sipas procedurës përkatëse;<br>• Të ruajë historikun e diagnozës së mjetit rregulloreve të brendshme;<br>• Të informojë klientin/eprorin për gjetjet dhe procedurat e mëtejshme, sipas rregullores së brendshme. |
| **<u>Funksioni 3</u>**<br><br>Mbikëqyr mirëmbajtje parandaluese | **<u>Detyra 1</u>**<br>Kryen kontroll të rregullt të gjendjes teknike të sistemeve në mjetin motorik<br>**<u>Detyra 2</u>**<br>Mbikëqyr shërbim periodik të sistemeve në mjetet motorike<br>**<u>Detyra 3</u>**<br>Mbikëqyr kontrollin dhe | • Llojet e mirëmbajtjeve periodike të motorit dhe procedurat përkatëse;<br>• Llojet e materialeve dhe karakteristikat e tyre sipas katalogut të prodhuesit<br>• Rëndësia e marrjes së informacionit nga prodhuesi për defektet e mundshme dhe përditësimi i tyre;<br>• Llojet e mirëmbajtjeve për turbo, | • I/e përgjegjshëm/me<br>• Korrekt/e<br>• I/e përpiktë<br>• Bashkëpunues /e<br>• I/e saktë | • Të kryejë kontroll periodik të gjendjes teknike të sistemeve në mjetin motorik<br>• Të mbikëqyrë shërbimet periodik të sistemeve në mjetet motorike sipas manualit të prodhuesit;<br>• Të mbikëqyrë kontrollin dhe zëvendësimin e pjesëve dhe |

| TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Funksionet** | **Përgjegjësitë /Detyrat** | **Njohuritë** | **Qëndrimet** | **Kriteret e performancës** |
| në kamionë dhe mjete të rënda | zëvendësimin e pjesëve dhe elementëve përbërës të mjetit për mirëmbajte periodike (sistemin e shkarkimit, sistemin e transmetimit të fuqisë, sistemin e drejtimit, sistemin e frenimit). | radiator i ftohjes së ajrit dhe sistemi i riqarkullimit /gazeve të shkarkimit;<br>• Llojet e sistemeve të monitorimit të gazeve të shkarkimit dhe procedurat e mirëmbajtjes periodike;.<br>• Llojet e transmisioneve: manuale, automatike dhe gjysmë automatike dhe procedurat e mirëmbajtjes periodike;<br>• Kutitë ndërmjetëse të shpejtësive për ngarkesa të rënda (reduktorët, rridoto) dhe procedurat e mirëmbajtjes periodike të tyre;<br>• Llojet e sistemeve të frenimit të mjeteve të rënda dhe procedurat e mirëmbajtjes periodike së tyre;<br>• Llojet e mirëmbajtjeve në sistemet elektrike dhe elektronike dhe procedurat përkatëse;<br>• Llojet mirëmbajtjeve dhe kalibrimeve të sistemit të amortizimit të mjeteve të rënda dhe procedurat përkatëse;<br>• Llojet mirëmbajtjeve në karroceri dhe sistemet shtesë dhe procedurat përkatëse;<br>• Sistemet hidraulike për vinça, rimorkio | • I/e kujdesshëm/me<br>• I/e vëmendshëm/me<br>• I/e komunikueshëm/me<br>• I/e dëgjueshëm/me<br>• I/e shkathët<br>• Sistematik/e | elementëve përbërësve të mjetit për mirëmbajtjet periodike ( në sistemin e shkarkimit, sistemin e transmetimit të fuqisë, sistemin e drejtimit, sistemin e frenimit) sipas manualit të prodhuesit;.<br>• Të mbikëqyrë kontrollin, nivelimin dhe cilësinë e lëngjeve në sisteme të ndryshme sipas manualit të prodhuesit;<br>• Të mbikëqyrë kontrollin dhe rregullimin e gjeometrisë së rrotave sipas manualit të prodhuesit;<br>• Të mbikëqyrë kontrollin dhe regjistrimin e mekanizmit të shpërndarjes së gazeve të motorit sipas manualit të prodhuesit;<br>• Të mbikëqyrë kontrollin dhe mirëmbajtjen e elementëve të sistemeve elektrike dhe telemetrike sipas manualit të prodhuesit;<br>• Të mbikëqyrë kryerjen kontrollit dhe mirëmbajtjes të sistemit të amortizimit të mjeteve të rënda sipas manualit të prodhuesit; |
| | **<u>Detyra 4</u>**<br>Mbikëqyr kryerjen e kontrollit, nivelimit dhe cilësisë së lëngjeve në sisteme të ndryshme | | | |
| | **<u>Detyra 4</u>**<br>Mbikëqyr kryerjen kontrollit dhe rregullimin e gjeometrisë së rrotave | | | |
| | **<u>Detyra 5</u>**<br>Mbikëqyr kryerjen kontrollit dhe regjistrimit të mekanizmit të shpërndarjes së gazeve të motorit | | | |
| | **<u>Detyra 6</u>**<br>Mbikëqyr kryerjen kontrollit dhe mirëmbajtjen e elementëve të sistemeve elektrike dhe telemetrike | | | |
| | **<u>Detyra 7</u>**<br>Mbikëqyr kryerjen kontrollit dhe mirëmbajtjes të sistemit të | | | |

| TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Funksionet** | **Përgjegjësitë /Detyrat** | **Njohuritë** | **Qëndrimet** | **Kriteret e performancës** |
| | amortizimit të mjeteve të rënda<br>**Detyra 8**<br>Mbikëqyr kryerjen kontrollit dhe mirëmbajtjes të karroceri dhe sistemeve shtesë të mjeteve të rënda | me platformë lëvizëse, kazanë ose pajisje të tjera ngritëse, mikser të ndryshëm dhe procedurat e mirëmbajtjes së tyre; | | • Të mbikëqyrë kryerjen kontrollit dhe mirëmbajtjes të karroceri dhe sistemeve shtesë të mjeteve të rënda sipas manualit të prodhuesit; |
| **Funksioni 4**<br>Mbikëqyr riparime në motor dhe në sistemin e transmetimit të fuqisë në kamionë dhe mjete të rënda | **Detyra 1**<br>Mbikëqyr riparimin/zëvendësimin e pjesëve të motorit si agregatit<br>**Detyra 2**<br>Mbikëqyr riparimin/zëvendësimin e pjesëve të sistemit të ushqimit me MDB (motor me djegie të brendshme)<br>**Detyra 3**<br>Mbikëqyr riparimin/zëvendësimin e pjesëve të sistemi i furnizimit me ajër<br>**Detyra 4**<br>Mbikëqyr riparimin/zëvendësimin dhe monitorimin e pjesëve të sistemit të shkarkimit<br>**Detyra 5**<br>Mbikëqyr riparimin/zëvendësimin të pjesëve të sistemit të | • Tipet e motorëve, parimi i punës dhe funksioni i tyre.<br>• Motorët me djegie të brendshme (MDB), ndërtimi dhe funksionimi i tyre;<br>• Mënyrat e kontrollit vizual dhe dëgjimor , defektet kryesore në motor si dhe procedurat e riparimit të tyre;<br>• Sistemi i thithjes , sistemi i shkarkimit dhe monitorimit të gazeve, funksionimi dhe ndërtimi , parregullsitë dhe metodat e riparimit të elementëve si dhe procedurat e çmontim/montimit të pjesëve të dëmtuara ;<br>• Sistemi i transmetimit të fuqisë, ndërtimi dhe pjesët përbërëse.<br>• Parametrat teknik të transmetimit të fuqisë; | • I/e përgjegjshëm/me<br>• Korrekt/e<br>• I/e përpiktë<br>• Bashkëpunues /e<br>• I/e saktë<br>• I/e kujdesshëm/me<br>• I/e vëmendshëm/me<br>• I/e komunikueshëm/me<br>• I/e | • Të mbikëqyrë riparimin/zëvendësimin e pjesëve të motorit si agregatit sipas manualit të prodhuesit<br>• Të mbikëqyrë riparimin/zëvendësimin e pjesëve të sistemit të ushqimit me MDB (motor me djegie të brendshme) sipas manualit të prodhuesit<br>• Të mbikëqyrë riparimin/zëvendësimin e pjesëve të sistemi i furnizimit me ajër sipas manualit të prodhuesit<br>• Të mbikëqyrë riparimin/zëvendësimin dhe monitorimin e pjesëve të sistemit të shkarkimit sipas manualit të prodhuesit |

| TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Funksionet** | **Përgjegjësitë /Detyrat** | **Njohuritë** | **Qëndrimet** | **Kriteret e performancës** |
| | transmetimit ( ingranazhe ose zinxhiri i shpërndarjes)<br><br>**Detyra 6**<br>Mbikëqyr riparimin /zëvendësimin e pjesëve të friksionit dhe volantin në mjete të rënda<br><br>**Detyra 7**<br>Mbikëqyr riparimin /zëvendësimin e pjesëve të transmisionit MT, AT dhe ridoto (kutia ndërmjetëse)<br><br>**Detyra 8**<br>Mbikëqyr riparimin/zëvendësimin e pjesëve të sistemit të transmetimit të fuqisë (diferenciali, reduktorët, boshti kardanik, gjysmë boshtet, rrotat lëvizëse).<br><br>**Detyra 8**<br>Mbikëqyr riparimin e sistemit të ftohjes së motorit<br><br>**Detyra 9**<br>Mbikëqyr riparimin/zëvendësimin e elementëve të sistemit të shkarkimit të gazrave dhe monitorimit . | • Volanti, friksioni , hidroxhunto, ndërtimi, funksioni dhe llojet ;<br>• Komandimi i friksionit, llojet (mekanik, hidraulik, elektromagnetik, pneumatik, robotik) ndërtimi, pjesët përbërëse dhe funksionimi i tyre dhe procedurat e riparimit;<br>• Kutia e ndërrimit të shpejtësisë (kambios), kutisë shpërndarëse ndërmjetëse, yjet (xhuntot) kardanike, llojet, ndërtimi dhe funksionimi dhe riparimi i tyre;<br>• Diferenciali, boshtet dhe gjysmë boshtet e transmetimit, mocot e rrotave dhe kushinetat llojet, ndërtimi dhe funksionimi , si dhe procedura e kontrollit dhe riparimit të tyre;<br>• Reduktorët, llojet, ndërtimi dhe funksionimi si dhe procedura e kontrollit dhe riparimit të tyre;<br>• Procedurat e testimit dhe funksionit të sistemit te transmetimit të fuqisë pas riparimit . . | dëgjueshëm/me<br>• I/e shkathët<br>• I/e duruar<br>• Këmbëngulës/e<br>• Fleksibël<br>• Praktik (SMART)<br>• I/E kujdesshëm/me për detaje; | • Të mbikëqyrë riparimin/zëvendësimin të pjesëve të sistemit të transmetimit ( ingranazhe ose zinxhiri i shpërndarjes) sipas manualit të prodhuesit<br>• Të mbikëqyrë riparimin /zëvendësimin e pjesëve të friksionit dhe volantin në mjete të rënda sipas manualit të prodhuesit<br>• Të mbikëqyrë riparimin /zëvendësimin e pjesëve të transmisionit MT, AT dhe ridoto (kutia ndërmjetëse) sipas manualit të prodhuesit<br>• Të mbikëqyrë riparimin/zëvendësimin e pjesëve të sistemit të transmetimit të fuqisë (diferenciali, reduktorët, boshti kardanik, gjysmë boshtet, rrotat lëvizëse) sipas manualit të prodhuesit;<br>• Të mbikëqyrë riparimin e sistemit të ftohjes së motorit sipas manualit të prodhuesit; |

| TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Funksionet** | **Përgjegjësitë /Detyrat** | **Njohuritë** | **Qëndrimet** | **Kriteret e performancës** |
| | **<u>Detyra 10</u>** Kontrollon parametrat e agregatëve pas riparimit. <br> **<u>Detyra 11</u>** Kryen kontrollin final dhe provën në lëvizje para dorëzimit të mjetit. | | | • Të mbikëqyrë riparimin/zëvendësimin e elementëve të sistemit të shkarkimit të gazrave dhe monitorimit sipas manualit të prodhuesit; <br> • Të kontrollojë parametrat e agregatëve pas riparimit sipas manualit të prodhuesit. <br> • Të kryejë kontrollin final dhe provën në lëvizje para dorëzimit të mjetit sipas procedurave; |
| **<u>Funksioni 5</u>** Mbikëqyr /kryen riparime në sistemet | **<u>Detyra 1</u>** Kontrollon presionin dhe rrjedhën në sistemet hidraulike dhe pneumatike të kamionëve dhe mjeteve të rënda <br> **<u>Detyra 2</u>** Identifikon rrjedhjet e mundshme në sistemet hidraulike dhe pneumatike të kamionëve dhe mjeteve të rënda. <br> **<u>Detyra 3</u>** Teston funksionalitetin e sistemeve hidraulike dhe pneumatike (ngritja e ngarkesës, | • Parimet dhe ligjet bazë të hidraulikës dhe pneumatikës; <br> • Parimi i funksionimit të sistemit me ajër të kompresuar. <br> • Dallimet ndërmjet sistemeve të mbyllura (hidraulike) dhe të hapura (pneumatike). <br> • Komponentët kryesorë të sistemeve pneumatik dhe hidraulik, si dhe funksioni i tyre; <br> • Leximi i skemave teknike (hidraulike/pneumatike/elektrike); <br> • Llojet defekte përmes simptomave dhe | • I/e përgjegjshëm/me <br> • Korrekt/e <br> • I/e përpiktë <br> • Bashkëpunues/e <br> • I/e saktë <br> • I/e kujdesshëm/me <br> • I/e vëmendshëm/ | • Të kontrollojë presionin dhe rrjedhën në sistemet hidraulike dhe pneumatike të kamionëve dhe mjeteve të rënda sipas udhëzimeve të prodhuesit; <br> • Të identifikojë rrjedhjet e mundshme në sistemet hidraulike dhe pneumatike të kamionëve dhe mjeteve të rënda sipas procedurave; <br> • Të testojë funksionalitetin e sistemeve hidraulike dhe pneumatike (ngritja e ngarkesës, ngritja e kabinës, frenimi, etj.) |

| TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Funksionet** | **Përgjegjësitë /Detyrat** | **Njohuritë** | **Qëndrimet** | **Kriteret e performancës** |
| hidraulike dhe pneumatike të kamionëve dhe mjeteve të rënda | ngritja e kabinës, frenimi, etj.). | procedurat e riparimit të tyre;<br>• Përdorimi i pajisjeve matëse dhe testuese (testues presioni, matës rrjedhjeje, manometër).<br>• Specifikimet e vajrave (lloji, viskoziteti, temperatura operative) dhe rëndësia e tyre në sistemet hidraulike;<br>• Komponentët kryesorë dhe funksioni i tyre<br>• Sistemi hidraulik (pompat, pistonat, shpërndarësit, filtrat, rezervuarët, radiator/ftohës vaji hidraulik) dhe procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të tyre;<br>• Sistemi pneumatik (kompresorët, rezervuar dhe filtra, valvula dhe shpërndarës, pistonat pneumatikë) dhe procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të tyre;<br>• Përshtatja dhe lidhja e linjave hidraulike dhe pneumatike.<br>• Kontroll i pajisjeve përmes levave, pultesh elektronike, | me<br>• I/e komunikuesh ëm/me<br>• I/e dëgjueshëm/ me<br>• I/e shkathët<br>• I/e duruar<br>• Këmbëngulës/ e<br>• Fleksibël<br>• Praktik (SMART)<br>• I/E kujdesshëm/m e për detaje; | sipas manualeve të përkatëse<br>• Të mbikëqyrë riparime/zëvendësime në komponentët e dëmtuar hidraulikë dhe pneumatikë (kompresorë, tuba, linja, valvola, rezervuar ajri) sipas manualeve të prodhuesit;<br>• Të kontrollojë parametrat e sistemeve hidraulike dhe pneumatike pas riparimit sipas manualeve të prodhuesit.<br>• Të testojë sistemet hidraulike dhe pneumatike në ngarkesë, pas riparimit manualeve përkatëse; |
| | **<u>Detyra 4</u>**<br>Mbikëqyr riparime/zëvendësime në komponentët e dëmtuar hidraulikë dhe pneumatikë (kompresorë, tuba, linja, valvola, rezervuar). | | | |
| | **<u>Detyra 5</u>**<br>Kontrollon parametrat e sistemeve hidraulike dhe pneumatike pas riparimit | | | |
| | **<u>Detyra 6</u>**<br>. Teston sistemet hidraulike dhe pneumatike në ngarkesë, pas riparimit | | | |
| **<u>Funksioni 6</u>** | **<u>Detyra 1</u>**<br>Kryen matjen e parametrave | • Ligjet bazë të elektricitetit | • I/e | • Të kryejë matjen e parametrave |

| TEKNIK I MEKATRONIKËS SË KAMIONËVE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Funksionet** | **Përgjegjësitë /Detyrat** | **Njohuritë** | **Qëndrimet** | **Kriteret e performancës** |
| Kryen riparime dhe zëvendësime në sistemet elektrike të kamionëve dhe mjeteve të rënda | elektrikë dhe i krahason me standardet dhe normat e përcaktuara në manualet përkatëse.<br>**Detyra 2**<br>Lokalizon defektin në sistemet elektrike, paketat elektronike dhe komponentët kompjuterikë.<br>**Detyra 3**<br>Kontrollon përputhshmërinë e pjesëve/elementeve për zëvendësim me specifikimet e tyre sipas kodeve dhe tipit të automjetit<br>**Detyra 4**<br>Kryen punime elektrike (çmontim/montim, riparim, zëvendësim, rregullim parametrash – kalibrim…) në sistemin e furnizimit me energji elektrike.<br>**Detyra 5**<br>Kryen punime elektrike në sistemin e ndezjes së motorit.<br>**Detyra 6**<br>Kryen punime elektrike në sistemin e ndriçimit, sinjalizimit dhe në funksione ndihmese të automjetit. | • Llojet e defekteve elektrike në sisteme;<br>• Pajisjet matëse të sistemit elektrik (indikator , multimeter , avometer, klapmeter etj. ) funksioni dhe përdorimi i tyre;<br>• Skema e sistemit të startimit dhe karikimit ndërtimi, parimi i punës, funksioni i tyre dhe procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të tyre;<br>• Procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të sistemit ndriçues dhe sinjalizues;<br>• Llojet e sistemit të ushqimit, mënyrat e testimit, riparimit dhe zëvendësimit, kalibrim, kodim injektorësh dhe procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të tyre;<br>• Llojet e sensorëve aktiv dhe pasiv, veçoritë e tyre sipas funksionit dhe procedurat e zëvendësimit dhe riparimit të tyre;<br>• Motorët elektrik HV, ndërtimi dhe funksionimi i tyre;<br>• Parametrat teknik dhe konstruktiv motorëve elektrikë HV;<br>• Llojet e baterive HV, ndërtimi, përbërja | përgjegjshëm/ me<br>• Korrekt/e<br>• I/e përpiktë<br>• Bashkëpunues /e<br>• I/e saktë<br>• I/e kujdesshëm/m e<br>• I/e vëmendshëm/ me<br>• I/e komunikuesh ëm/me<br>• I/e dëgjueshëm/ me<br>• I/e shkathët<br>• I/e duruar<br>• Këmbëngulës/ e<br>• Fleksibël<br>• Praktik | elektrikë dhe i krahason me standardet dhe normat e përcaktuara në manualet përkatëse sipas procedurave të paracaktuara;<br>• Të lokalizojë defektin në sistemet elektrike, paketat elektronike dhe komponentët kompjuterikë, në bazë të diagostikuesve dhe pajisjeve testuese;<br>• Të kontrollojë përputhshmërinë e pjesëve/elementeve për zëvendësim me specifikimet e tyre sipas kodeve dhe tipit të automjetit, sipas katalogëve të prodhuesit; .<br>• Të kryejë punime elektrike (çmontim/montim, riparim, zëvendësim, rregullim parametrash – kalibrim…) në sistemin e furnizimit me energji elektrike , sipas manualeve të prodhuesit dhe programeve kompjuterike;<br>• Të kryejë punime elektrike në sistemin e ndezjes së motorit sipas manualeve përkatëse;<br>• Të kryejë punime elektrike në |

